



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Predato Received/Delivered	11. 02 1	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK/604/2021			113



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.10/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar,Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses,ka shqyrtuar ankesën me numër protokoll 52/2021 të datës 08.01.2021, të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi Rr “Agron Krasniqi ” nr. 10 Fushë Kosovë, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “transfer”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I.Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër **A.nr.10/2021** e datës 08.01.2021,e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II.Shfuqizohet** Vendimi me numër protokoll 347, i datës 18.12.2020 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës.
- III.Obligohet** zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij duke e kthyer ankuesen në pozitën Udhëheqëse e Ekipit të Kontrollit në Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj.
- IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.
- V.Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.**

A r s y e t i m

Ankuesja znj. [redacted] e punësuar në pozitën Udhëheqëse Ekipi në Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj në Administratën Tatimore të Kosovës sipas Akt emërimit të datës 11.11.2019, me vendimin e datës 18.12.2020 me numër protokoll 347, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës e ka transferuar ankuesen për kohësisht prej datës 01.01.2021 deri më 30.06.2021 në pozitën Zyrtare e Lartë Tatimore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 11.01.2021 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses e ka proceduar tek Administrata Tatimore të Kosovës. Me datën 19.01.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës faqe 1/12.

Administrimi i provave-Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesa me numër protokoll 52/2021 e datës 08.01.2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Akt emërimi i datës 11.11.2019; E-mail i datës 21.12.2020; Vendimi për transfer i datës 18.12.2020 me numër protokoll 347; Kopja e kartelës së punësimit; ID identifikuese; Vendim i datës 06.08.2019 për transfer i nxjerrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës; Vendimi i datës 23.09.2019 me numër protokoll 730; Akt emërimi i datës 15.08.2015 me nr.02/244/29 për E-mail zyrtar i datës 19.01.2021-dërgimi i provave shtesë në lidhje me ankesën e ankueses znj. Hafize Krasniqi; Autorizimi i MAP-it i datës 10.09.2019; Miratimi për publikimin e rekrutimit të brendshëm i datës 10.09.2019; Kopja e konkursit të brendshëm të datës 16.09.2019 me numër protokoll 693; Regjistri i kërkesave të pranuar për pozitën Udhëheqës i Ekipit të Kontrollit i datës 23.09.2019; Vendimi i datës 25.09.2019 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni rekrutues i datës 04.10.2019; Njoftimi për kandidatët e suksesshëm i datës 08.10.2019 me numër protokoll 891; kopja e testit me shkrim e datës 01.10.2019 e kandidates me 92 pikë të fituara dhe Përgjigje në ankesë e datës 19.01.2021 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/12.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët,ka konstatuar se ankesa e ankuesit **me numër A.nr.10/2021, e parashtruar nga [redacted] është e bazuar, sepse:**

Kolegji,ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses,e cila pretendon se transferimi nga pozita Udhëheqëse e Ekipit të Kontrollit në Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj në pozitën Zyrtare e Lartë Tatimore për Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat në Divizionin për Procedura-Departamenti i Kontrollit dhe Procedura, është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Bazuar në shkresat e lëndës të Kolegji, ka konstatuar se sipas Akt Emërimit të datës 11.11.2019, ankuesja është emëruar në pozitën e Udhëheqëses se Kontrollit në Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj, ndërsa Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, me Vendimin e datës 18.12.2020 me numër protokoll 347,ka transferuar ankuesen përkohësisht prej datës 01.01.2021 deri më 30.06.2021 në pozitën Zyrtare e Lartë Tatimore.

Kolegji për vlerësimin e pretendimeve ankimore të ankueses ka analizuar Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregullohen Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, nga dhe ka konstatuar se Vendimi me numër protokoll 347 i datës 18.12.2020 i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së për transferimin e ankueses nga pozita Udhëheqëse e Ekipit të Kontrollit në Departamentin e Tatimpaguesve të Mëdhenj në pozitën Zyrtare e Lartë Tatimore është nxjerrë në kundërshtim me nenin 52 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 4 paragrafi 1 Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku është përcaktuar se "Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nenin 52 paragrafin 1 të Ligjit". Mbi këto fakte Kolegji konstaton se transferimi i ankueses nuk është bërë në kategorinë e njëjtë, por nga kategori e ulët udhëheqëse në kategorinë profesionale. Andaj rrjedhë se pretendimet ankimore te ankueses janë të bazuara.

Po nga shkresat e lëndës Kolegji për shqyrtimin e ankesës ka konstatuar se vendimi i goditur më ankesë nuk përmban sqarimin e nevojshëm dhe mjaftueshëm lidhur me nevojën e Institucionit për transferimi e ankueses në pozitën e Zyrtares së Lartë Tatimore. Vendimi me numër protokollit 347 i datës 18.12.2020, si arsye të transferimit të ankueses thekson se pozita në të cilën është transferuar ankuesja është pozitë e lirë, e në kuptim të kësaj Kolegji vlerëson se pozita e lira plotësohen me procedurat e përmes lëvizjes në detyrë apo ngritjes në detyrë, ashtu siç parashihet me nenin 38 dhe 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRTËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.10/2021, datë 11.02.2021

Sabile Avdyli
Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Administratës Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.